



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nr.01-060/01-8043/23 datë:27.03.2023



Npi – 01/112 datë: 29.03.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT
E mbajtur më datën: 29.03.2023 (e mërkurë) në ora 10:00 h. në sallën e vogël

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja, znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, z.Hamëz Tërshani, z.Rexhep Gashi dhe znj.Arbenita Brahimi. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe:

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit; znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 27.02.2023,
2. Raporti i punës për 3mujojin e parë nga DKA dhe DKRS,
3. Informatë rreth realizimit të 7 Marsit-Ditës së mësuesit,
4. Informatë nga DKRS rreth shënimit të Epopesë së UÇK-së,
5. Informatë nga DKRS rreth infrastrukturës sportive, kulturore,
6. Raporti vjetor i DKRS për punët dhe aktivitetet e OJQ-ve gjatë vitit 2022.

Kryesuesja, znj.Albana Podvorica; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Asllan Beqaj; Përshëndetje, unë jam për këtë rend të ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, pajtoj me rendin e ditës, materiali na ka ardhur sipas planit të punë punës. Nuk mundemi me i elaboruar informatat, pa qenë prezent edhe drejtoresha.

z.Asllan Beqaj; Informatat na kanë ardhur me kohë dhe kemi pas kohë të mjaftueshme për me i lexuar, kështu që konsideroj se gjithçka është në rregull.

z.Rexhep Gashi; Replikë, nëse mundemi për dy orë, e marrim një pauzë e lexojmë informatën.

z.Hamëz Tërshani; Rexha e dinë që me ardhë drejtoresha në mbledhje është mirë. Por është mirë që e ka dërguar një informatë.

znj.Arbenita Brahimi; Përshëndetje, pajtohem me parafolësit sepse edhe me qenë drejtoresha këtu prezent nuk kishte çka me thënë më shumë, përveç se çka shkruan në informatë.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 27.02.2023

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht, miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KAKRS-së e mbajtur më 27.02.2023.**

Pika 2

Raporti i punës për 3mujorin e parë nga DKA dhe DKRS

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Asllan Beqaj; Për këtë pikë mendoj se i kemi dy mundësi, ose e diskutojmë këtu, ose e lëmë që ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.


z.Hamëz Tërshani; Ne nuk mund ti obligojmë drejtorët që të marrin pjesë në mbledhje, nuk mundemi me i obliguar sepse edhe ashtu ne si komitet jemi jo-obligativ.

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Nëse nuk keni diçka për me diskutuar unë propozoj që mbledhjen me e përfunduar.

***Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht, vendosi që mbledhjen ta përfundoi në mungesë të drejtorëve.**

Kryesuesja, znj. Albana Podvorica; Pasi që diskutime të tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 10:19h

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Albana Podvorica

